


# • • • • • • • • • Studime te Shkurtra Biblike • • • • • • • • •

Eckhard Neumann

Still i jetes  
i Natyralitetit dhe

Konsekuences





© Josua-Verlag im  
Christlichen Missionswerk Josua e.V.  
Botim i Misionit Kristian Josua e.V.  
Kirchsteig 6  
O-1185 Berlin

1. Botimi i parë: 1993  
Kopertina: Joseph Avakian  
Perkthyer nga: Tone Berisha

Renditja: Josua-Verlag  
Shtypja:: Josua-Verlag

Eckhard Neumann

**Stil i jetes i Natyralitetit dhe  
Konsekuences**

Josua-Verlag

## Përbajtja

---

Parathënje .....	1
Hyrje .....	
Kapitulli 1 - Një anë e dashurisë të Jezusit .....	2
Kapitulli 2 - Ana e "tjetër" e dashurisë se Jezusit .....,	3
Kapitulli 2.1 - Natyralitet .....	4
Kapitulli 2.2 - Konsëkuencë/ Radikalitet .....	5
Kapitulli 2.3 - Pa mirësi për njerëz .....	6
Kapitulli 3 - Jezusi punonte vetëm me ata që kishin vullnet .....	7
Kapitulli 4 - Jeta në Shpirtin e Shenjtë do thotë edhe vuajtjë .....	8
Kapitulli 5 - Guxim, një virtyt i Shpirtit të Shenjt... <td>9</td>	9
Kapitulli 6 - Secillin të fitojsh ? .....	10
Kapitulli 7 - Shembuj negative dhe positive të kohë sotme .....	11
Fund .....	12

## **Parathënie i botimit të dytë**

---

Botimi i parë është botuar me titullin jo me shprehim të fortë: "Ana e 'tjetër' është karakterit të Jezusit". Megjithatë ishte pas ca jave e rrëmbyer. Në botimin e dytë është përmirësuar dhe ndryshuar pak dhe është punuar posaquerisht qeshtja e natyralitetit të Jezusit.

Për këtë arsyen ka dalur një studim të shkurtër dhe të aktualizuar. Me këtë studim do të inkurajohën udhëheqët dhe krishterët, të ecin me vendosmëri në rrugen e rifillimit përmes Shpirtit të Shenjtë. Një stil i jetës i natyrshem dhe me konsekuençë i sjelli Jezusit një jetë me fuqi në Shpirtin e Shenjtë- kjo do të ndodh edhe në jetën tëndë, i dashuri lexues. Zoti të bekofte !

*Eckhard Neumann*

## Hyrje

---

A e deshi Jezusi atë, që e thej kurorën? Unë bësoj, që cdokush do të përgjigjet ketë pytje me "po". A i deshi Jezusi farisenjtë Po, ne gjith sinqueritetin e vetë, por mendo kur tē pergiqjësh, që Jezusi i thoshtë atyre shumë fjalë tē renda. Mëgjithatë thotë në Mat. 11,29:

**"Vjeni vetën nën drejtimin tim dhe mësoni tek unë: atëherë do të gjeni paqën e vertetë"**

Prej Jezusit më mesue, prej natyrës e Tij, prej dashurisë e Tij, do të thotë më mësue prej burimit, prej Tij vetë. Shkaku i keti punjimit të shkurtër biblike Nr. 3 është i veçantë. Në vitin 1983 isha shumë i semurë, po, isha shumë afër vdekjës. Pasi që shpetova prej vrerës të shpërthyar (operacion në vrerë), ndodhi që të gjeljnë trombose në kembë. Zotit i qoftë lavdi dhe falenderim, që më shpëtoj dy herë! Ati i qoftë lavdi! Pasi që edhe sëmundja në kembë ishte duke sheruar, Zotit fliste më mua. Në mua degjova zërin e Zotit (jo zë që degjohët). "Lexo jetën e Jezusit!" Kjo ishte per arsyen që mendoja që e nifsha jetën e Jezusit shumë besfasueshme. Në shtepi ku jam irritë më kanë treguar tregime biblike. Unë shkojsha rregullisht në takimët të rinjvë në kishen pentekoste, në sherbim, po unë isha dy apo tri herë në jave gjithsej 5 deri 6 orë nën fjalën e Zotit. Për ketë arsyen unë e nifsha jetën e Jezusit shumë mirë, kështu mendojsha unë. Për këtë arsyen kisha veshtirësi ta pranoj fjalën e Zotit në zemrën time. Pasi kjo fjalë nuk u zhduk, vendosa, ta bej këtë. Unë

fillova një studim që gjati shumë javë për jetën e Jezusit në Besëlidhjën e Re, dhe me duhët të thëm, që mua m'u paraqit një pasqyrë të jetës së Jezusit. Natyrisht i pash do pjesë në karakterin e Tij, që i kisha mësuar në kishën pentekoste. Ai ishte Jezusi, që i don të gjitë, dhe që është i perulur dhe i zemërbutë, etj. Këtë pasqyrë të Jezusit e nifsha shumë mirë prej predikimëve të ndryshmë. Por ana e tjetër e dashurisë se Tij nuk e nifsha dhe mua më befasoj, që sa shpesh Besëlidhja e Re shkruan per këtë. Mua mu paraqit një Jezus, që ishte konzekuent dhe radikal, dhe që vuajti për vërtetën, dhe që e thoshtë vërtetën edhe kur nuk ishte e peshtatëshme. Unë i lexova fjalët në Bibel, që ishin radikal dhe unë e kuptova, që Zoti lëjoj që të vdes Jezusi në kryq. Zoti ishte shumë radikal me Jezusin, dhe këtë pjesë e karakterit e Tij, qartësija dhe konzekuenca, është në çdo moment në jetën e Jezusit. Pas studimët e Biblës m'u paraqit një tjetër Jezus. Pasi që i tregova këto mendime edhe tjérëvë, e dëgjova në vitin 1987 gjatë kursit të dishepujëve të katërt prej shtat-dhjetor prapë fjalën e Zotit në zemrën time, pertë përhapur këtë mendim edhe më lart. Ky punim i shkurtër të Biblës është shkruar për udhëheqët dhe krishterë, të cilët janë të gatëshëm të marrin përgjegjësi në rilindje. Po, do të realizohet ç'ka shkrunk në Gjoni 7, 38 + 39:

**“Kush me beson mua, siç thuhet në Shkrimin e shenjtë, burimi i ujit të gjallë do të rrjedhë nga zemra e tij. Me këtë Jezusi mendonte për Spirtin e shenjtë që duhej ta merrnin ata që i besoni atij. Atëherë Spiriti i shenjtë ende s’ishte dhënë, sepse Jezusi s’ishte ngritur ende në qiell.”**

Dhe më besuar siç thotë Bibla- për të rjedh ujët të gjallë ! Ky punim i shkurtër nuk është një shtesë për diskutim teologjisë, por një ndihmë për pytjët ne jetë dhe në udhëheqje. Vargjet e Biblës janë nga Bibla në gjuhën shqipe.

## Kapitulli 1

### Një anë e dashurisë të Jezusit

---

Në këtë kapitull të shkurtër dua të shënoj do fakte të njojur, që janë në do krishterë shumë të gjallë dhe që e karakterizojnë dashurinë e Jezusit. Jezusi neve na paraqitët, kur flet natën me Nikodemusin, dhe si Jezusi mund të dirigoj biseda tek të rilindja. Ai nuk deshi që Nikodemusi të vijë të Ai ditën. Jezusi është shumë i zënë. Shumë njerëz janë rrëth Tij, që kërkojnë diçka, që pyesin, kërkojnë sherim dhe mesim etj. Ndërsa nxënësit i refuzojnë fëmijët, Jezusi ka koh për ata, bile i merr afër vetit, i bekon dhe i drejtohët atyre plotësisht. Në e njofim edhe atë, që bëri kurorthyrje, për atë na tregon Bibla ne Gjon. 8, 3-11. Kur të gjith e urdhërojnë ta denoj atë, siç e detyron ligji. Jezusi është asaj, pasi ata duke e vërejt fajin e vetë largohën:

(Vargu 11)

**“Mirë -tha Jezusi-edhe unë nuk po  
dënoj. Mund të shkosh; por mos e bëj më atë  
që bëre -ky është mëkat i rëndë!”**

Kështu e shofim Jezusin, kur Ai qan ndonjë herë, kështu edhe në Luka 19,41:

**“Kur Jezusi u afrua dhe e pa qytetin që  
shtrihej para tij, qau për të.”**

Këtu e shofim, si Jezusi qan për Jerusalemin. Një varg në Gjon. 11,35, kur Jezusi qan të varri i Lazarit. Ka shembujë tjetra që mund të citojnë për këtë qeshtje. Bibla thotë ne

1. Gjon. 4,16:

**“Sidoqoftë ne jemi plotësisht të bindur që Perëndia na do. Perëndia është dashuri. Kush jeton në dashuri, jeton në Perëndinë dhe Perëndia jeton në të.”**

Sepse Zoti edhe Jezusi kan karakter të njëjtë, edhe Jezusi është dashuri. Ai është dashuria e Zotit, e cila është zbuluar në Atë.

## Kapitulli 2

### Ana e “tjetër” e dashurisë se Jezusit”

---

#### 2.1 Natyralitet

Jezusi ka ardhur në botë, sepse ishte i degjueshëm ndaj Atit, për të shpëtuar. Ai ishta biri i Zotit por edhe njeri. Ai Jetonte pas vullnetit të Zotit. Gjithmon thoshte: “**Kush me shikon mua, e shikon Zotin**”. Në Jezusin e shofim Atin dhe të Ati shofim shumë fije natyrale të karakterit, ashtu edhe në parajsë: kur Zoti ka bashkësi me njërz, më Adamin, e ka pa mungesën e tij, që i mungonte ni ndihmëse, një grue. Zoti nuk ishte i pakuptueshëm, që nuk e vërejti mungesën të Adami, përkundrazi Ai e pa dhe u kujdes për atë. Ai ishte shumë natyral dhe e pa jo vetëm mungesën frymore. Një shenjë tjetër është, që Zoti erdhi të Adami në mbrëmjë. Ai kishte kujdes të vij, kur ishin kushtë më të mira për komunikacion. Ai mendonte mos të vij në mësditë, kur ishte nxehjtë, sepse Adami ndoshta atëherë kishte vështire të degjonte Zotin, sepse ishte duke u ndjërsitur. Edhe në qiel ne tregohët, që Zoti edhe Jezusi kanë mardhënie natyrale me njëri tjetrin. Ne lexojmë në Gjon. 1, 18 :

**“Askush kurrë nuk e pa Perëndinë, por Biri i vetëm, që vetë është Perëndi, i një natyre me Atin, ai e bëri të njohur.”**

Jezusi ka qenë në prehën të Atit. Lexuesët, që janë vet prindër, mund të parashofin, siç ka qenë aty. Këtu e shofim, si ata kanë kaluar shumë natyral si Atë dhe Bir.

Sigurisht ka pasur edhe përkëdhelje, kanë biseduar edhe qeshur, lexojmë në Psalm 2,4 si Zoti qesh ! Kjo vërtëtohët edhe në zbulësë, që neve ne tregohët në qjell nuk do të ketë lot, por gëzim dhe qeshje. Zoti qesh edhe Jezusi poashtu, sepse Ai neve ne tregon Atin. Në ardhjën e Tij në tokë engjujt i lajmërojshin barijëve në Lluka 2, 10:

**"Mos kini frikë, sepse po vij te ju për t'ju  
dhëne një lajm të mirë për të cilin do të  
gëzohet i tërë populli i Izraelit."**

Engjujt thonin: Tani vjen të ju ni gëzim i madh nëpër Jezusin. Kur 70 dishepuj u kthyn prej shërbimit të atyre ka 2 ka 2, në lexojmë, që ata kishin gëzim të madh dhe ata e lajmëruan Jezusin. Unë gjithmon e pys vehtën, ku ata e mësuant këtë gëzim të madh. Më siguri në bashkësi më Jezuin, sepse aty ishte gëzim i madh. Dhe në Lluka 15,32 e marrim ni urdhër për t'u gëzuar. Ati i thotë në shëbull për birin e humbur vëllaut, që kishte mbetur të shpt: "Po megjithatë duhet të gëzohemi e të gjallërohem." Ni urdhër për t'u gëzuar dhe kështu thotë Jezusi në Gjon. 15,11:

**"Jua thashë këtë që të mbusheni me gëzim  
dhe që të mos ju mungojë më asnje gëzim."**

Jezusi kishte gëzim për të dhënë: "**Gëzimin tim po ju jap.**" Ai kishte gëzim për të dhënë nxënësëvë. Për këtë arsyesh tashmë më rëndësi, që në mësohemi, që të gëzohëmi, edhe në vështërsi në Jezusin. Këtë urdhër e shosim edhe në besëlidjën e vjetër, gëzimi në Zoti të jetë forca e juaj. Forca e Jonë do të jetë gëzimi në atë. Natyraliteti i Jezusit dokumentohët në dasmën në Kana, ku Jezusi kishte shkuar për të festuar, edhe jo për të predikuar, për

të mbajtur fjalim. Eshtë zakon, që ne në dasëm qeshimi dhe gëzohemi me dhendrin dhe nusën. Jezusi duke njoftur këto ishte në dasëm. Aty Ai e bëri mrekullin e parë, Ai bëri vërë prej ujit, aty në Kana. Me siguri kishin thanë ata, që janë të shenjtë, Jezus, këtë mundesh me bë, sepse njëri prej tyre mund të pijët prej vëres. Por Jezusi e pa munësën e prinderit dhe ju kushtuar kujdes atyre. Ai kishte kujdes dhe ishte shumë natyral për të pa ç'mugesa kanë njérëzit në rrëthanën e Tij, duke kaluar më nxënësët në Galile apo në Jude. Ai kishte kujdes për rrëthim shoqeror. Ai nuk e pe vetëm nevojët shpirtërore të nxënësëvë të vetë edhe ju ndihmonte por Ai i pe shumë të qart rrëthanat soqerore. Ai i pe delët dhe qobanët, Ai i pe zogjët në fush, Ai i pe vreshtët më degë e hardhi. Kur predikonte, i përdor këto figura, për të sqaruar diçka. Në këtë menyrë çdokush e kuptonte, kur tregonte për qobanin e mirë, që e jep jetën e vetë për dele apo kur sqarontë, që dega duhët të rri në hardhi, për të bi fruta, si edhe në duhët të rrijmë të Zoti; të burimi. Kështu Zoti kishte kujdes për ambientin e vetë, dhe vërentë të gjitha. Jezusi jetonte shumë qetë, shum natyral, Atij ishin sendë të ligjit shumë lartë, dhe Jezusi është dhe do të jëtë shembulli i jonë, sepse Ai thotë në Mateu 16,18 : **"Unë do të ndërtoj bashkësinë tonë."** Dhe Bibla thotë, që Jezu Krishti është kryet e bashkësisë. Ai ka si krye drejtë të thotë siç paramendon që të paraqitët trupi. Dhe të jetonim aq natyral, aq të drejt dhe konsekuent si Ai, është detyra e jonë. Por si mund të mësohëm të jetojmë në menyrë natyrale, a mund të mësohët natyraliteti ? Po, është e mundur, kur në e parafytyrojmë jetën e Jezusit, si ka jetuar jo në ekstrem të ligjit dhe kur unë e pranoj stilin e jetës së Tij. Një shëmbull ngajeta e ime. Në fillim të martesës tonë: unë kam menduar shumë koh t'ia ndaloj

gruas time Christel thurjën nē "dielēn e shenjtē", sepse mendojsha se nuk ēshtë me vend. Por unē nuk mendoja, qē ajo aty e kā qejfin dhe qē kjo pēr kētē arsyē pelqen sumē mirē me ditēn e diel. Edhe unē kisha nevojë tē mēsoj sepse isha nga ambienti tradicionale, kur vija nē levizjēn e Shpirttit tē Shenjtē. Dua tē ju kēshilloj qē tē keni kontakt me krishterē natyral, nē tē cilēt mund tē shifesh nje natyralitet dhe liri tē lidhur me Zotin. Kur isha nē ambient tradicinale dhe ligjore, ishte shumē mirē, kur rrīja me njérēz, qē e kishin njē stil natyral tē jetēs, qē nuk deshin tē paraqiten si tē shenjtē, por qē ishin aq tē lirē tē natyrshēm, kēshtu qē ēshtē gēzim i madh tē kish kontakt mē ata. Kētē stil tē jetēs e kam parē sidomos tē "krishterē tē mēdha" nē mbretērinē e Zottit. Kēshtu kam mesuar natyralitet nē afērsi tē njérēzēvē natyral dhe kēshtu po tē kēshilloj edhe ty, lexues i dashur, nē kētē menyr tē mēsosh tē kesh karakter natyrale.

## 2.2 Konsekuencë/ Radikalitet

---

Sqarimi i dashurisë e Jezusit me lartë është e lidhur me vijën e konsekuencës dhe radikalitetit. Ai Jezus, që qan, i flet ca njerëzëvë shumë fjal të rënda, atyre që nuk vepronin, siç flisnin. Sepse është plot mëshirë, shëron në shtunën e mëdha, me të cilën Ai e rrezikon jetën e vet. Jezusi e lëshoj vullnetarisht madhështin e qiellit dhe jetonte jetën "tonë", sepse ishte i bindur nga Ati.

Fil. 2,5-8:

**"Kini vazhdimisht parasysh çfarë shembulli na ka lënë Jezusi,Mesia: Në gjithëka ai ishte i njëllojtë me Perëndinë,e meghjithatë nuk kapej pas privilegjeve hyjnore,por hoqi dorë nga ato vullnetarisht dhe u bë si një skillav.U bë njeri në këtë botë dhe mori pjesë në jetën e njerëzve.Nga dëgjesa ndaj Perëndisë,u poshtërua aq shumë saqë ju nënshtrua edhe vdekjes,madje vdekjes së një krimineli në kryq."**

Jezi Krishti pret, që kosekuanca, që kishte në jetën e vet, të përdorin edhe pasardhët e Tij. Kështu Ai kërkoj dhe priste prej nxënësëvë, të leshojnë të **gjitha** dhe të vijnë pas Tij. Ai priste, që të lëshojnë profesionin, familjën, eksistencën, sigurinë dhe të vijnë pas Tij. Në lexojmë ne Lluka 9,59-61 fjalët vijuesë:

**"Edhe një tjetri i tha:" eja pas meje!" por ky i përgjigj: "Më lejo, Zot, më parë të shkoj ta varros babain." "Lëri të vdekurit - iu përgjigj Jezusi - t'i varrozin të vdekurit r tyre. Ti duhet të merresh me spalljen e lajmit për mbretërinë e Perëndisë." Edhe një tjetër i tha: "Unë do të vij pas teje, Zot, por më parë më lejo të ndahem nga familja imë."**

Të dy thojnë: **Zot, me lejo, më parë...**, kjo do thotë unë më parë, mua më parë... Jezus nuk i lejon njerëzëvë, që dojnë të vijnë pas Tij, të shkojnë dhe të varrozin apo të përshendetën. A nuk është kjo pedante? Çka kishte humbur Jezusi, nesë i kishte thanë njërit: sa ditë të duhën për varrim? Ndoshta ai ishte përgjigj: po, me gjitha përafërsisht 3,4 apo 5 ditë. Çka kish humbur Jezusi nesë ai kishte ardhur 5 ditë më vonë të grupi i atyre? Me siguri jo shumë, por Jezusi e dinte një, që nesë Ai e fillon pasardhjën e tij me lëshime, ai gjithmon kishte më than: "Po, Jezusi dhe deshirat e mia, deshirat e mia dhe Jezusi, Jezusi dhe deshirat e mia." Në jetën e tyre nuk do të ketë konsekuenc apo qartësi, për këtë arsyе Jezusi është në këtë vend i qartë dhe konsekuent. Mendimin-mua më parë, nuk ka që të bej. Pasardhja kushton të gjitha, të kushon ty, jeta e jote- jeta e jote personale- emri i yt i "mirë". Ni fjal radikale gjindet në Bibel në Mateu 10,34-39:

**"Mos mendoni se erdha që të sjell paqen në bottë. Nuk erdha për të, por për t'ju sjell përçarjen. Erdha ta ndaj birin nga i ati, vajzën nga nëna, nusen nga vjehrria. Më të afërmít do të jenë armiq me njëri-tjetrin. Kush e do të atin e t'ëmën me shumë se mua, nuk**

**është i denjë të jetë nxënësi im.Kush nuk e merr kryqin e vet e nuk vjen pas meje,nuk është i denjë të jetë nxënësi im.Kush do ta ruajë jetën e tij,do ta humbë.Kush do ta japë jetën e tij për shkakun tim ,do ta rifitojë.”**

A mund të paramendojsh fjalë më radikale apo më të qart si këto ? Jezusi kërkon prej pasardhjet e Tij këtu ni ndamje totale dhe pret, që ata të donin më parë atë dhe që të gjitha Jane pas Tij. Një fjal nga Bibla, që e ilustron pasardhjen e Jezusit më gjithë radikalitet dhe konsekuenc: Mateu 16,24+25:

**“Pastaj Jezusi u tha nxënësve vet:”Kush do të vijë pas meje,duhet të heqë dorë nga vetja si edhe nga dëshirat e tij;duhet ta mbajë kryqin e vet dhe të vijë pas meje të rrugën time.Ai,pra,që do ta shpëtojë jetën e tij,do ta humbasë.Por kush e humb jetën e vet për hirin tim,do ta gjejë përsëri.”**

Prej ketyre fjalëvë në Bibel mund të shofim një. Nesë nuk je i gatshëm të jesh konsekuent në pasardhje, atëherë harro të gjitha. Nesë nuk je i gatshëm me marr kryqin mbi veti dhe me ardh pas Jezusit dhe më ve kusherinjtë më të ngushtë në vendin e dyt, pastaj kështu thotë Bibla nuk je i vlefshëm për Atë. Jetë, jetë e vertetë e gjëjmë në Jezusin ! Në e shofim këtë radikalitet edhe në jetën e Jezusit dhe në jetë e pasardhjëvë të Atij. Nxënësët e Jezusit lëshonin të gjitha dhe ecnin pas Tij; pa përshendetjë, pa u menduar, ecnin pas Jezusit. Të jesh krishterë, pasardhes i Tij, d.m.th. me humb jetën, jetën tëndë, dhe me humb emrin

e "mirë" dhe me hyj në mbretërinë e Zotit. Kosekuencën e Jezusit e praktikojnë dishepujt në jetën e vet. Kjo sqarohët pas ngjitjës e Jezusit në qill, kur ata të pagëzuar me Shpirtin e Shenjtë ecnin rruges e tyre më fuqin e Tij. ( Veprat e Apostujve 1.4+5 dhe Veprat e Ap. 2. 1-4). Ne e përjetojmë, si ata në koh të shkurtër rane dy herë në burg (Vepr. e Ap. 4, 1-3 edhe Veprat e Ap. 5, 17+18), edhe si ata merrën nga udheqët kishtar të asaj kohë në pytje. Pergjigjët e tyre janë karakteristike:

Vepr. e Ap. 4,19:

**"Ju duhet të vendosni nëse është e drejtë  
në sy të Perëndisë t'ju dëgjojmë më tepër ju  
sesa Atë !"**

Vepr. e Ap. 5,29:

**"Duhet më tepër të dëgjohet Perëndia se sa  
njerëzit."**

Lidhjët e tyre me fjalët e Zotit shkahtonin, që ata predikonin me guxim. Rezultatët e vërtetojnë guximin e tyre, si p.sh.

Vepr. e Ap. 5,11-16:

**"Mbarë bashkësia dhe të gjithë ata që  
dëgjuan për këtë , u trembën shumë. Me anë  
të apostujve u bënë shumë vepra të  
mrekullueshme ndër popull. Bashkësia e  
kishte bërë zakon të mblidhej e tëra në  
sallën e Solomonit. Askush prej atyre që  
qëndronin jashtë nuk guzonte t'i trazonte;  
por të gjithë flitnin plot respekt për ta.  
Gjithnjë e më shumë njerëzit i besonin  
Jezusi, të cilin e pranonin për Zot dhe**

**lidhesin me bashkësin. Ata i sillnin të sëmurët jashtë në rrugë dhe vendosin atje në shtoja e në vigje, kështu që , kur Pjetri t'u kalonte pranë , së paku hija e tij t'i binte ndonjërit prej tyre. Edhe nga rrëthinat e Jeruzalemit, të shumtë ishin ata që i sillnin të sëmurët dhe të pushtuarit nga djalli dhe të gjithë u shëruan."**

Zoti është në anën e atyre, që veprojnë konkuient, atë që e thotë. Përvojët në madhështi, fuqi dhe në shërim është diçka, që e deshirojmë më gjith shpirtë për jetën në bashkësitë tonë.

## 2.3. Pa mirësi për njerëz

Vargjet në Bibël vertëtojnë sesa pak Jezusi ishte i interesuar për të arritur mirëdashje të udhëheqët kishtar. Me siguri kishte bashkepunuar me ata ne qoft se ata kishin një zemër të singert dhe të drejt. Por Ai e pe që ata gjithmon flisnin ndryshe sase vepronin, dhe për këtë arsyen Ai i kundërshtonte atyre. Në Mateu 23,13-24 ata quan 7 herë hipokrit. Ai e arsyeton këtë me qendrimin e zemrës, që ata bëjn fjalë, të cilët nuk i realizojnë. Kjo do të thotë diçka, kur Jezusi i flet këto fjalë udhëheqëve kishtar të asaj kohe ! Në Luka 11,44<sup>o</sup> i quan "varre të mbuluar".

Interesant është në këtë kontekst vargu në Bibël, Mateu 22,16:

**"Ata i thanë: Mësues, ne e dimë se ti merreshh vetëm me të vërtetën. Ti i tregon troç secilit siç duhet të jetojë sipas vullnetie të Zotit. Në të vërtetë , ti nuk lejon të ndikohesh nga njerëzit, edhe në qoftë se janë të fuqishëm."**

Këtu e shofin edhe farisenjtë, që Ai nuk është i vëmendshem për mirëdashje nga njërezët. Ne nuk gjëjmë në jetën e Jezusit mirësi për njerez. Në të vërtet Jezusi me këtë ka "prishur" shumë në jetën e vetë, sepse nuk është munduar, me bashkëpunu me udhëheqët kishtare. Mirësi për njerez është pas urdhëresës së parë shërbim idhujve ! ( Kur ne thojmë apo bëjmë diçka, për t'i pelqyer njerëzëve.) Jezusi thotë në Gjoni 5,41:

**"Unë nuk kërkoj nderimin e njerëzve."**

Në kapitull të njëjtë shprehet Jezusi (Gjon. 5,44):

**"Ju i jepni shumë rëndësi të pranoni lavdi nga njëri-tjetri; por nuk kërkon lavdinë që vjen nga Perëndia."**

Kështu shofim që Jezusi nuk përdor në jetën e vet takтик për t'i kthyer njerzit. Jezusi nuk caktonte shkëmbim mendimësh nga ana e vetë me njerez, që ishin kundër Tij, me qellim m'i bind për mendimin e vetë. Jezusi nuk diskuton me farisenjtë apo me njerëz tjérë, me qellim m'i treguar, që ka qellim të mirë në zemër, kur ata ishin kundër Tij. Në Mateu 13,9-14 gjindet tregimi i shërimit i njerit me dore të tharë:

**"Jezusi shkoi më tutje dhe hyri në sinagogën e tyre. Atje ishte një njeri që e kishte dorën e paralizuar. Farisenjtë kërkonin ta zinin ngushtë Jezusin dhe përkëtë e pyetën: "A është e lejueshme që ndokush të shërojë ditën e shtunë?" Jezusi u përgjigji. "A ka ndër ju njeri të tillë që, po i ra e vëtmja dele që ka, në gropë, në shtunën, nuk e nxerr? E megjithatë njeriu është më i vlefshëm se delja! Prandaj është e lejueshme t'i ndimohet njeriut të shtunën!"**

**Pastaj i tha njeriut: "Shtrije dorën/tënde!" Njeriu e shtriu dorën dhe dora iu bë e shëndoshë si tjetra. Pas kësaj farisenjtë dolën jashtë dhe ranë dakord që ta vritin Jezusin."**

Ky shërim ndodhi ne shtunën e mëdha dhe përfundimi ishte që farisenjtë mendojshin si kanë mundësi të mbysin. Ky shërim i sjell nga pikëpamja njerëzore vetë zemërim. Kjo mund të mos ndodh, kur Jezusi i kishte thanë atij me dorë të tharë: "Të lutem, eja një ditë më vonë, atëherë unë do të shëroj. Unë do të gjindëm në këtë vend. Eja më mirë në këtë koh." Ai kishte kursye shumë zemërim dhe kjo nuk kishte ndodh, që farisenjtë donin ta vrissnin. Burri me dorë të tharë kishte jetuar edhe një ditë me dorë të sëmurë. Jezusi nuk kishte humbur asgje, por në këtë shëmbull të veprimit shifet gjith sinqeriteti, drejtësia, ndershmëria dhe konsekuenca e Jezusit. Ai ishte kundër interpretimit të shtunës së mëdha. Jezusi sheronte, kur ishte nevoja, sepse kishte urdhër të Atit. Atij ishte më këndshëm, t'i shërbej dhe pelqej Zotit sa njerëzevë. Një shëbull tjetër gjëjmë në tregimin e shërimit e burrit në liqenin e Betesda. Ai ishte se 38 vjet i sëmurë, në Gjon. 5,8+16-18. Edhe ky shërim ndodhi në shtunën e mëdha edhe në këtë rast ata shikonin ta vrissnin. Në jetën e Jezusit e shofim një menyre të jetës, që nuk bën lëshime në llogari të vërtetës. Kjo i sjell Jezusit shumë armiq, por Jezusi përkundrazi i ka mbajtur këto principe. Ai kurr nuk bën diçka për t'i pelqyer njerezve. Ky qendrim është edhe për Palin karakteristike, sepse ai shkruan në Gal. 1,10:

**"A mund të më paditni tani se ju mbusha mendjen (për të pranuar një udhë më të lehtë të shpëtimit)? Atëherë mund të më paditni se ia mbusha mendjen Perëndisë! Mos mendoni ju se u bëj lajka njerëzve? Unë i takoj Mesisë dhe i shërbej atij - si mund të kërkoj duartrokitjen e njerëzve?"**

Puna e atij ishte orientuar pas Zotit, Atij më i pelqye, me vepra dhe me fjal.

Një gjë e rëndësishmë ishte një pasdite karismatike biblike në Götz. Aty u predikojke dhe u shpall në qartësi, që mirësia pë njerez është shërbim idhujve. Kur unë pash, që kjo kishte fundamente në Bibël unë u tremba, sepse unë gjëjsha këtë gabim edhe në jetën time. Unë kisha folur në rrëthim e krishtërve gjysme-karismatike në menyr gjysme-karismatike dhe në rrëthim e krishtërve plot-karismatike ndryshe. Në kuptimin e Biblës së plot.

Unë kisha folur para njerëzëve, siç prisnin ata. Sepse unë disha, çka mendonin ata dhe për këtë arsy unë folsha ndryshe. Unë e pash, që kjo ishte mëkat. Unë u pendova dhe vendosa, m'u nda nga

mirësia për njerëz (posaquerisht në fjalime). Unë vendosa m'i pelqyar vetëm Zotit. Aty u shpall edhe shlirim nga vesi inderit, dhe përgjigja e Zotit është: i nganjur me dashurinë e Zotit, pushimi në Zotin, siguria dhe mbrojtja në Zotin, pranimi dhe bolleki i dashurisë së Zotit.

Kërkesa në shërbimin tanë është kjo: nga kush jam i emëruar? A me kanë emëruar njerzet (ni institucion) apo jam i emëruar nga Zoti?

Ju jeni sherbëtori atij, i cilit i bindeni!

## Kapitulli 3

### Jezusi punonte vetëm me ata që kishin vullnet

---

Grupi që e zgjodhi Jezusi ishin njerëz, të cilët i thirri dhe cilët kan pasë një perqigje të qartë. Nëve na tregohët që Jezusi kur nuk ka lidh njerëz me vehten, cilët nuk deshin, por Ai vetëm bashkëpunonte me ata, që ishin me vullnet dhe qejf pasardhes. Ne Marku 10, 17-27 ne tregohët tregimi për djalin e pasur. Ky vjen dhe bjen para Tij në gjunj dhe flet me Atë: "Mësues, me trego çka duhet të bez që të vij në qiell?" Kur Jezusi i tregoj, që duhet t'i mbaj urdhërimët, ai u përgjigj. Unë i mbaj urdhërimët. Jezusi e shef dhe e don. Ai nuk j' refuzon fjalët e djalit, por i panon me dashurinë e vet. Ne mendojmë, këtu është një krishterë i vërtetë. Por kur Jezusi e përmend pasurinë e tij dhe djafl vendos me u largu, Ai nuk e ndal as me vepër as me fjal, edhe nuk mundohët të bë lëshime sa i përket kërkësës e vet. Si kishim vepruar ne në këtë situat? A i kishim shkuar pas për me bisedur me atë? Si përshembull: Mirë, mjaftron edhe i dheti, nesë i jap këto edhe pak më shumë, sepse je i pasur, e përkrah mbretërinë e Zotit." A kishim diskutuar me atë, a kishim biseduar, biseduar dhe prap biseduar? Jezusi këtë nuk e ka bërë, Ai e ka lëshuar djalin, pa e provuar, me zhvilluar një bisedë, për të ndryshuar qendrimin e djalit. Kaq i kunsekuent ishte Jezusi! Atëherë na përshkruhët si Jezusi është sjell me nxënësët e vet. Ne lexojmë në Gjon. 6,66-67:

**"Kur dishepujt e tij e dëgjuan këtë, shumë nga ata i kthyen shpinën dhe s'donin tanëndiqin më. Pastaj Jezusi pyeti të**

**dymbëdhjetë nxënësit." E ju, çfarë keni  
ndër mend? A doni të më lini edhe ju?"**

Jezusi e ka mbajtë një fjalim për gjellën e mishit Të Birit të Zotit dhe pijen e gjakut Tij. Ne vargun 60 lexojmë: "Kjo është një fjalim i rendë. Kush mund ta degjon?" Prej këti momenti shumë veta u larguan prej Jezusit. Interesant është reagimi i Jezusit. Ai nuk i thotë atyre: Rrini bile ju, sepse nuk kam asnjë më, por Ai flet me qartësi: A doni të shkoni edhe ju??? Ai i ka thirr: Ejani pas meje! Dhe ata lëshuan të gjith dhe vinin pas Tij. Dhe këtu vepron shumë qartë. **Jezusi nuk e ndali askend, që vendosi me shkue !** Ai nuk u munduar për ta bind dikënd, që të rrin, përkundrazi Jezusi nuk e ndali askënd që kishte vendosur për të shkuar. Ai e pranonte plotësisht vullnetin e atyre. Jezusi e dinte, që kur shkojnë ata që kanë deshir të shkojnë, vijnë tjerët, më shumë që kanë deshir të rrijnë.

Jezusi i le nënesëvë vendimin e lirë.

## Kapitulli 4

### Jeta në Shpirtin e Shenjtë do thotë edhe vuajtje

---

Përpara që Jezusi filloj të bëj vepra, Ai është pagëzuar me Shpirtin e Shenjtë pas pagëzimit me ujë ne lumen Jordan ( Mateu 3,16+17). Ai punonte me fuqinë e Shpirtit të Shenjtë (Lluka 4,14). Kjo është një fakt i mrekullueshëm, që ne jemi me të njëjtin Shpirtin Shenjtë, më të njëjtin shërbim jemi pajis. Haleluja ! Jezusi punonte dhe operonte vazhdimisht me Shpirtin e Shenjtë. Ai punonte ne menyrë mbinatyrore. Këtu gjeljmë gjithmonë veprime ne dhurata frymore: parashikime, sherime, fjal të njojurisë, fjal të urtësisë, mrekulli për dallime të shpirtrave tjera. Jeta me Shpirtin e Shenjtë sjell përndjekje. Jezusi thotë ne Predikimin ne Mal, Mateu 5,10-12:

**“Lum ata që persekutohen, sepse kryejnë atë që kérkon Zoti. Ata do të banojnë më Të në mbretërinë e Tij. Lum ju kur njerëzit ju shajnë dhe ju përndjekin dhe thonë gjithfarë të zezash kundër jush pa të drejtë, sepse më takoni mua. Gëzohuni dhe ngazëllohuni, sepse Zoti do t’ju japë shpërblim të madh. Po kështu, para jush, i trajtuan edhe profetët.”**

Neve na thojnë, që do të këtë përndekje për drejtësi. Këtë duhet të marrim parasysh: pë drejtësi (natyrisht jo për vepra të këqijal). Jezusi e ka përjetuar këtë vuajtje mjaft ne jeten e vetë. Kështu lexojmë në Mateu 12,24:

**"Por kur i dëgjuan këto, farisenjtë i kundërshtuan : Ky nuk i dëbon djatë vetë, por kryetari i djajve i jep pushtet për këtë."**

Jezusi akuzohët, që Ai bën vepra të shlerimit me anë të Satanes, kryetarin e djallave, që Ai vetë e ka djallin (Marku 3,22). Jezusi thotë shumë qartë, që edhe ne do t'i përjetojmë përndjekjet, etc, si Ai. Ne këtë vens do varge të Biblës: Mateu 10,16+17 dhe 21+22. Jezusi thotë, që as kusherinjtë nuk do të na kuptojnë. Ata do të kthejnë shpinen, edhe na urrejnjë, deri të rrähja me kamxhik. Prej njejtit kapitull varget vijuese (mateu 10,25+26):

**"Nxënësi duhet të jetë i kënaqur kur trajtohet si mësuesi i tij dhe skllavi kur trajtohet si i zoti. Në qoftë se zotin e shtëpisë e quajtën Satan, aq më tepër do t'i shajnë njerëzit e tij. Mos kini frikë nga asnjë njeri! Ajo që është ende e fshehur, duhet të dalë në dritë, dhe ajo që asnjeri akoma nuk e di, duhet të zbulohet."**

Ndoshta e ke përjetuar edhe ti, që vlezërit apo motrat kanë thanë, që e ke djallin. Jezusi thotë: kjo është normal, mos ke frikë! Nesë je ne sherbimin e shlerimit, ta dish, që kjo është një shenjë për ardhjen e mbretërisë së Zotit. Jezusi thotë në Mateu 12,28:

**"Por në qoftë se unë të Shpirtin të Perëndisë i dëboj shpirrat e këgji, atëherë është e qartë se Perëndia tashmë ka filluar ta vendosë sundimin e tij mes jush."**

A nuk je krenar, që je ne pozitën e Jezusit apo zemërohesh, që njerëzët flasin për ty ? A mos kanë folur edhe për Jezusin, dhe a është muduar të arsyetohët, pse duhet ti të arsyetohesh ? Gezohu që ki drejtë t'a përjetojsh njejtën si Jezusi, edhe vuajtjet.

Në Gjonin 15,20+21 flitet për këtë mendim:

**“Kini parasysh se çfarë ju thashë:” Asnjë shërbëtor nuk është më i madh se i zoti.Si më përndoqën mua, ashtu do t’ju përdjekin edhe ju. Më pak i besuan fjalës sime , edhe më pak do t’i besojnë fjalës suaj. Të gjitha këto do t’ju bëjnë, sepse ju keni besim tek unë. Ata nuk e njohin Atë që më dërgoi.”**

Përndekjët cilet i ka përjetuar Jezusi, do t’i përjetojmë edhe ne, dhe ne nuk do të turpërohëm për ato.

Vargun ne Bibel Mateu 16,24+25 e kemi cituar, ku Jezusi thotë: “Kush do të vijë pas meje, duhet të heqë dorë nga vetja si edhe nga dëshirat e tij;duhet ta mbajë kryqin e vet dhe të vijë pas meje të rrugën time.Ai,pra,që do ta shpëtojë jetën e tij,do ta humbasë.” Përndekja është ne jetën e ni dishepuj të Jezusit normal. Vetëm fakti i pasëardhjës të qart dhe kosekuanca ne mbretërinë e Zotit do të sjell përndekje. Apostulli Pali e ka shkruar një fjalë të qart në 2. Timoteu 3,12:

**“Secili që dëshiron, në lidhje me Jezusin,  
Mesinë, të bëjë një jëtë që i pëlqen Perëndisë,  
do të pësojë përndjekje.”**

Ai shrkuan këtu, që nesë njerëzit kanë deshirë të jetojnë në gëzim të Zotit, do të vuajn nga pérndjekje. Pérndjekja është pjesë e kesaj.

Në 2. Tim. 1,8 thuhet:

**"Ndërhyr edhe për mua që jam në burg për hirin e tij, dhe të jesh gati të vuash bashkë me mua për lajmin e mirë. Perëndia do të të japë fuqi për këtë."**

Këto vujtje janë të përshkruar si një ndodhi normale. Edhe Apostulli Pali shkruan mendime të njëjtë ne 1. Pjetrit 2,19-23:

**"Perëndia do t'ju japë ndihmën e tij, në qoftë se duhet të duroni vuajtjet e pësimit të pamerrituar, sepse jeni besimtarë. A keni ju ndonjë arsyе për t'u krenuar në qoftë se keni bërë ndonjë të keqe pë të cilën ju rrahin? Por në qoftë se keni punuar drejt dhe duhet ta pësoni për këtë, Perëndia do t'ju ndhimojë. Pikërisht për këtë Ai ju ka thirrur. Ju e dini se Mesia e pësoj për ju dhe kështu ju la një shembull. Qëndroni në rrugën që e hapi: ndigini gjurmët e tij. Për atë thuhet: "Nuk bëri asnjë të keqe. Kurrë nuk doli nga goja e tij ndonjë fjalë e gjenjeshtërt. Kur e fyen, nuk ia ktheu. Kur duhej ta pësonte, nuk i Kërcënoi me hakmarrje, por u mbështet në Perëndinë duke e ditur se Ai do t'i jepte të drejtë."**

Pjetri shkruan këtu për thirrjen me vuajt, edhe ai shkruan, që kjo është një ndodhi normale. Nesë deshiron një jetë krishterë pa përndjekje, pa vuajtje, atëherë deshiron diçka çka Jezusi nuk ka premtuar nxënëseve të vet. Për këtë të jesh i gatshem, përndjekjët dhe vuajtjet për Jezusin t'i bajsh dhe durosh. Mos u turpëro të jesh si Krishti sepse Ai është në ne (Gal.2,20). Sepse Jezusi jeton në ne, ne jemi si Ai. Bibla n'a thotë, ne jemi prej Perëndisë apo si Ai (Veprat 17,29). Kemi mundësi të pranojmë prej Zotit një jetë si të Atij ! Ne jemi ni soj perëndishem, Haleluja !

Ne i takojmë familjes perëndishem me anë të rilindjes, ne jemi femijët të Perëndisë. Haleluja !

## Kapitulli 5

### Guxim, një virtyt i Shpirtit të Shenjt

---

Të hedhim shikimin shkurtimisht në Besëlidhjen e Vjetër, para se të kthehem i tij Jezusi: është interesant se si ligji i luftës të popullit Izrael është perdon. Zoti donte vetëm njerëz guximtar në luft, 5. Mosiu 20,2-4+8:

**"Nesë vini deri të grindja, duhet të vij priftëri dhe të flet me popullin dhe të tregon: Izrael, degjo! sot do të dileni në grindje kundër armiqt të juaj; zemëra jote mos u frigofit, mos u frigoni dhe mos u trembeni dhe mos lejoni të tmerroheni para tyre; sepse Perendia, Zoti i juaj, është me ju, të luftoj kunder armiqët, për të ndihmuar juve. Dhe njerzët ne detyrë duhet të flisnin me popullin. Cili prej jush frigohet dhe e ka zemren e dobët, ai të shkoj dhe të kthehet ne shpi, mos të i bën zemrat e vllazërvë frigacake, si është zemra e tij."**

Këtu mund të shofim, që si janë priftërit e Zotit. Priftërit flasin me inkuarim, me qellim më ndertuar, flasin, çka Zoti flet, thonë, që Zoti është me ne, flasin për guxim kundër frikës. Ata e inkurajojnë popullin, vargu i 8 ne na njofton, që ai i cili nuk kishte guxim mund të shkoj ne shpi. Zoti donte vetëm njerëz guximtar të shkojnë në luft dhe arsyat për këtë neve na sjellet; që mos të i frigojnë zemrat e vllazërvë, si ishin zemrat e tyre. Zoti ka kuptim

për këtë, që mjaftojnë vetëm ca njerëz guximtar, për të fituar lufthen, që si me qenë ne një grup me të mëdha ca njerëz, cilët i bejnë tjerët të paguximshëm dhe frigacak. Ne i gjëjmë ca shëmbuj biblike për një vepër të tillë. Këtu e shosim pë shëbull Gideonin, i cili shkon ne Juft kundër Filistianvë. Më Gideonin ishin 32.000 njerëz. Zoti i tha Gideonit këtë (Gjykatësit 7,3):

**"Kush është frigacak dhe i zemërlëshuar,  
të kthehet!"**

Këtu lejonte Zotit, që kush është frigacak dhe i zemërlëshuar, të kthen në shpi. Atëherë u kthyen prej ushtrisë 22.000 ushtarë, kështu që mbeten vetëm 10.000. Më në fund Zoti i zgjodhi vetëm 300 vet për luft.

Pra Lavdi Zotit, që guximi mësohët. Unë nuk kam nevoj të frigo hem, kur mua me mungon guximi. Një shembull biblike i mirë është Davidi, i cili mësonte me qenë guximtar dhe me u rritë në guxim. Para që të del para Goliatit, kishte mundësi të provoj guximin e vetë dhe të ushtroj. Kështu ai e mbyti një luan dhe një ari, para

që të del me von me plot sukses kundër Goliatit. Edhe një ngjarje me rendësi nga jete e Davidit: Davidi ishte në ikje me njerëz të tij ne vend të filistianvë. Në një situat të veçant, ne këtë situat të luftes ishin tërhek femrat e tyre, kur donin ta vrasin me gur (1. Samuel 30,6+7). Ndërsaata ishin para tij dhe donon ta vrasin me gur, lexojmë që **Davidi u forcuar në Perëndin**, Zotin e tij. Kjo është një shembull i një guximit të veçant, që neve na njoftohët. Në këtë situat të rrezikshme Davidi mbahët total në Zotin. Davidi i thonte vazdimisht vehtës: "Me Zotin tim mundem ... me Zotin tim mundem.." (Psalme 18,30).

Jezusi ishte sa i përket guximit shembull i vërtetë. Kështu lexojmë, që ne Nazaret, kur e refuzonin dhe donin ta hedhin prej malit, ai shkonte midis tyre Luka 4,29+30:

**“U ngritën, e dëbuani nga qyteti, dhe spunë gjer në rrëpirën e kodrës në të cilën ishte ndërtuar qyteti i tyre, me qëllim që ta rrëzonin poshtë(që ta vritnin pastaj me gurë). por Ai kaloi i papenguar nepër turmë dhe shkoj në një vend tjetër.”**

Për këtë duhet një guxim i jashtëzakonshem. Megjithatë shumë ngjarje matutje i dallojnë prap virtyten në jetën e tij. Kur Juda bashkë me ushtarët e kërkonin Jezusin ne Getsemane, ai i doli përpara dhe i u tha:  
(Gjoni 18,4+5 ni pjesë)

**“Kë po e kërkoni?” UNE JAM (AI).**

Ai nuk mshefet dhe del ne menyrë mbrojtsë para nxenësëvë të Tij:

**“Prandaj në qoftë se më kërkoni mua, le të shkojnë këta të tjerët.”**

shkruan ne vargun 8 të njëjtit capitull. Kjo ngjarje e verifikon guximin e Tij.

Udhëheqëve të asaj kohë më ia thanë vertetën, për më i kthyë përmes shokit (ai i quan 7x hipokrit në Mateu 23), është një shenjë i sinqueritetit guximtar.

Në këtë menyr është sjell edhe me gruan të bunari e Jakobit, kur i foli vertetën për jetën e asaj përmes fjalët të njobisë( Gjoni 4,18):

**"Je matuar pesë herë dhe ai me të cilin  
jeton nuk është burri yt!"**

Në këtë rast kishte metoda me shok sukses të jashzakonshëm, sepse shumë nga qyteti u kthyan në besim (Vargjet 28+29+39), edhe veprimi i Tij në tempull dëshmon prap guxim të mëdha dhe jetë pa lëshime (Gjoni 2,13-17), kur fliste dhe vepron te pas fjalevë.

Edhe Pjetri ka mësuar guximin në shkollë e Jezusit. Duke e tradhtuar Jezusin, kur ishte nevoja të rrinte tek Ai, dhe pastaj kur e pranoj faljen dhe kur u kthyer dhe kur e pranoj Shprtin e Shenjtë, ishte Pjetri në gjendje, me reaguar ndryshe, kur e kishte obligim të del para gjyqit të lartë. Tani nuk vërentë askush frikë, Veprat 4,11+19;

V.11:

**"Guri që ndërtuesit e hodhën si të  
papërdorshëm, u bë gur themeli."**

V.19:

**"Por Pjetri dhe Gjoni u përgjigjën: Ju duhet  
të vendosni nëse është e drejtë në sy të  
Peredisët t'ju dëgjojmë ju më tepër sesa  
Atë."**

Kur e kishin ndaluar të shpall emrin e Jezusit, ata u luten me bashkësin në Vargun 29 e kapitullit 4 për guxim, për të predikuar emrin e Jezusit në Shprtin e Shenjtë:

**"Tani dëgjo, o Zot, si na kërcenojnë. Na  
jeptani neve shërbëtorëve të tu fuqinë ta  
shpallim lajmin tënd me plot guxim dhe me  
vendosmëri!"**

Dhe në Veprat 4,31 neve na tregojnë, që ata e kanë shpall lajmin me guxim. Kë tu e shosim, që Pjetri përmes shpirtit e Shenjtë ka mësuar të jetë i guximshëm.

Sjellja e tij para gjyqit të lartë kishte ndikim të mëdha

(Veprat 4,33):

**“ Me anë të fjalës se tyre dhe me anë të mrrekullive që i kryenin, apostujt dëshmonin pë Jezusin si Zotin e ringjallur, dhe Perëndia i dhuronte me bollëk, mbarë bashkësin, të mirat që bënte Shpirti i Tij.”**

Një varg në Bibel ne Veprat 5,11-16, e cituar në kapitullin 2, në të cilën neve na tregohët për shumë shenjët dhe mrrekullive të cilet sjellin sherim dhe kthime.

Këtë guxim e shosim edhe në jetën e apostujt të Palit. Ai shkruan vetë, që sumë herë është deshpruar, ka përjetuar vrasje me gurë, i ka ra hajdutave në dorë etj. dhe megjithatë e ka shpall fjalën e Zotin më plot guxim. Ai shkonte në Jeruzalem edhe kur e dite që çka e prat. Pali ishte një burr i guxishmë, që e predikonte fjalën e Zotit me plot guxim dhe nuk kishte kujdes për jetë e vet.

Guxim si një virtyt i Shpirtit të Shenjtë mund të mësohët. Ku mund të marrim guxim ? Pra, të Zoti ! Ne lexojmë të Selanikasve 2,2:

**“...Por Perëndia na dha guxim që t'juá shpallim pa frikë lajmin e mirë të shpëtimit, megjithësë kishte kundërshtim të madh ndër ju.”**

Pali shkruan këtu që ata kishin guxim (çiltërsi)në Zotin. Ne gjëjmë, çka kërkojmë-Lavdi Zotit ! Ti gjën, çka të kërkojsh ! Kjo nuk është mëshir e fatit, që ti je i paguximshëm. Unë vet kisha në fillim të martesës time frikë të shkoj në zyre të banesave ose në çfarëdo zyre. Unë desha të çoj gruan time në zyre, ndërsa ajo tha: "Ti je udhëheqi i familjes. Ti duhet të shkosh." Unë kam gjetë guxim, Haleluja ! Ti mund të ushtrojsh dhe të pjekësh. Fillo !

Dëshmo me gëzim fjalën në Filipianëve 4,13 dhe beso:

**"Mund të qëndroj përballë gjithçkaj, sepse Mesia më forcën e nevojshme."**

## Kapitulli 6

### Secillin tē fitojs?

A ēshtē munduar Jezusi tē fiton secillin? A ka provuar Jezusi tē punon me secillin? Kēnd ke dēshirē t'i shērbejsh? A je zgħedhur prej njerëzēve apo i thirrur prej Zottit? A punon si Jezusi? Le tē shofim qartē, qē Jezusi nuk ka mundur t'i fiton tē gjith. Edhe prj rrethit tē ngushtē Juda u dalluar si tradhtar. Edhe ne mes tē nxenxēvē tē Tij nuk ka arrit sukses 100%.

A do tē arrijmē mē shumē sesa Jezusi? A nuk do tē mēsohemu mē mirē tē punojmē si Jezusi? Sepse taktika e Jezusit ka qenē e sukseshme. Qartēsija e Tij, sinqeriteti dhe konsekuenza ka sjell ndjekje, por edhe sukses tē mēdha. Sepse tērē bota ēshtē arritur, sepse pasēardhjēt e Tij bēnin ċka ka thanē Ai. Ai kanē shkuar si misionar nē botē dhe e kanē shpall lajmin e mirē nga Jezusi. Edhe ata thonin si Mesia, qē mbretērija e Zottit ēshtē afér, ata shēronin tē sēmuarit, i largojsin shpirtat e kēqij, i ngallshin tē vdekurit. Pēr Kētē arsyē le tē punojmē mē ata qē kanē dēshirē tē punojnē dhe le tē kemi lirinē mbretērore, t'i lēshojmē ata, qē kanē dēshirē tē shkojnē. **Nuk e kemi obligim t'i fitojmē tē gjith!**

Jezusi neve na ka thirr tē kryem **veppen e Tij!**  
Jezusi kurr nuk ka pasur bisedē mē armiq mē qēllim t'ia mbush mendjen.

Nē Mateu 23 shkruan si Jezusi i ka vlerēsua farisenjtē. Kjo bisedē nuk ka ndodh vetēm me farisenjtē, por Ai fliste me gjith populliñ edhe me pasēardhjet dhe ai e arsyetonte vlerēsimin esfarisenjēve me kētē, qē ata nuk veprojshin pas fjalëve..

Ne e dijmë, që udhëheqët kishtar, farisenjtë edhe priftat e refuzojshin Jezusin, përveç do përjashtime.

Edhe që kishte biseda përmes tyre, kjo ndodhtë sepse ata e pysnin Jezusin.

Ai nuk është munduar të fillon biseda, t'ia mbush mendjen njerëzëve që Ai ka deshir t'i ndihmon njerëzëve dhe që ka qëllim të mirë.

Këtë anë të karakterit nuke shofim në jetë e Jezusit. Përatë isht më me rendësi, me qenë i drejtë në sy të Perëndisë !

Një shembull i nje pastorit të kishës protestante do të thëlloj këtë mendim:

Ky pastor është një krishterë i rilindur dhe i pagëzuar me Shpirtin e Shenjtë. Bashkësija, ishte përberë prej dy grupesh, një grup, cili ishte i hapur veprimit të Spirtit të Shenjtë dhe që priste një rifillim të bashkësisë dhe grupi tjetër, që kishte deshirë t'imbaj traditat të përparshme. Ky pastor provoj me zjarr dhe vetëmohim, t'i sherbej grupit të dytë, në mënyre që kishte biseda me ata. Ai mendonte, që kishte mundësi t'ia mbush mendjen për mendime të veta. Këtë e bëri me vetëmohim të mëdha, por ai nuk kishte sukses. Pas ca jave dhe muaj ishte fizikisht dhe psiqikisht i lodhur saqë kishte nevojë të shkoj në spital. Ne spital nuk gjetë asnjë shenjë semujë fizike. Siç duket ishte ky vëlla psiqikisht i lodhur. Pas ca jave pushim është përmirësuar gjendja shëndetsore.

Vëllëzerit dhe motrat, që nuk deshin rilindje ne bashkësi, kishin pas mundësit t'izvëndsojnë udhëheqjen me vëllezer dhe motra të një mendimit dhe kështu i treguan pastorit, që mund të braktis bashkësin. Mendimi i pastorit ishte kjo: unë jam pastori i gjithë anëtarëve në bashkësi, unë duhet t'i sherbej gjithëve.

Siç duket nuk i ka dalluar vëllëzerit dhe motrat që janë të dobët dhe atyre të cilët nuk duan.

Jezusi neve na tregon në Mateu 18,12 tregimin e njeriut, i cili kishte 100 dele dhe njëra prej ketyre kishte humbur dhe ai flet: ky njeri do t'i le këto 99 dele për të kërkuar njërin. Siç duket këtu behët fjalë për një dele, që e ka humbur rrugen. Kjo do të thotë që delja është një pasqyre për një besimtar të dobët, që nuk e gjën rrugen dhe ka nevojë pë ndihmë.

Situata dallon kur një njeri nuk don. Kur ai nuk don të shkoj një rrugë të caktuar, kjo është e shkruar në Gjon. 6 shumë qartë.

Kur shumë njerëz u larguan pas fjalimit të rendë, Jezusi nuk e ndali **askënd**. **Askënd!** Më një qndrim të ngritu i le të shkojnë.

Edhe nxënësëve që ankohen i thotë: "**A doni të shkoni edhe ju?**".

Leni të mësojmë edhe në këtë rast prej Jezusit. Fjala që predikohët në Shpirtin e Shenjtë ka një pasojë të ndarjes

(Hebr. 4,12):

**"Fjala e Perëndisë është e gjallë dhe vepron. Ajo është më e imprehtë se çdo shpatë me dy presa: përshkon aq sa ndan frymën dhe shpirtin, hyn gjer në palcë. kërkon llogari nga dëshirat më të fshehura dhe nga mendimet e njeriut."**

Edhe njëherë: ne nuk e kemi obligim të fitojmë të gjith. Le të ndërtojmë mbretërinë e Perëndisë me gjith fuqi me ata që kanë me të vërtetë deshirë të dalin përpara.

## Kapitulli 7

### Shembuj negative dhe positive të kohë sotme

---

Në këtë kapitull do të përmenden ca shembuj, prej atyre ne mundemi të mësojmë.

Në ish-Gjermaninë lindore ka ca bashkësi, në të cilën pastori e kanë përjetuar një rilindje personale. Ata deshmojnë - ca haptas, ca vetë para shokëve- që e kanë përjetuar pagëzimin në Shpirtin e Shenjtë dhe që flasin në gjuh të reja. Megjithatë nuk ka ne shumë bahkësija nisje, nuk ka rilindje. Sepse shumë prej ketyre pastorëve nuk kanë guxim, sepse kanë frikë prej ndjekjës apokanë deshirë t'i shërbejnë të gjithëve, edhe ata që nuk duan të hyn në rifillim, nuk do të sjellin nisje.

Një udhëheq i të rinjëve nga një bashkësijë me ka treguar këtë: kur e verëti që mund të ketë mundësi të hyn në dimenzine të reja vetëm me sinqeritet dhe kosekuenc, i ka lutur të gjith në udhëheqjen e vetë të shkojnë, nesë nuk janë të gatshem të ecin para me gjith konsekuenc dhe me gjith vetëmohim dhe të pagujnë çmimin përrifillimin. Kur ikën ata, që nuk ishin të gatshem, filloj të jetë një bekim i mëdha në këtë rreth. Rrethi i të rinjëve u zmadue deri 50-70 vjetë.

Një anglez, Martin D., tregonte në muajn pril 1988 këtë shembull nga bashkësie që ishte rritur në Southhampton/ Britania e mëdha: Bashkësia kishte marr në lutje që duhet të ndërtojnë një bashkësi të re në ishull New Jersey. Me 6 veta filluan dhe kjo bashkësi u zmadhuar brenda 18 muajsh të 20-25 anëtar. Pas kësaj erdhën fjal, thashetheme etj. në këtë grup. Udhëheqja veproj menjëherë. Ajo fliste për principe biblike dhe thotë në qartësi të saktë, si duhet

të sillen në këtë situat. Pas kesaj u zvogëluar grupi për gjysmë, do thotë gjysmja e bashkësisë iki. Ç'deshtim dhe ç'zvogëlim ishte kjo ! Por pas një viti është zmaduar bashkësia deri 100 anëtar.

Unë e njoh një bashkësi (Berlin), në të cilën anëtarët kishin deshirë t'a braktisin bashkësine. Atyre i thonin tjerët të veprojnë në këtë menyrë. Askënd e ndalin. Bashkësia është e mësha dhe është duke rritur. Pas një shtatistik të gazetës "Gemeindewachstum" (Rritja e bashkësive) Nr. 4/90, Faqja 36, është deshmuar që pas mysafrëve në vikend kjo bashkësi kishte vizitë më të mëdha në tërë Gjermaninë, kjo bashkësi është një bashkësi karismatike.

Këto shembuj ne tregojnë, siç me paqartësi, me pelqim njerzore dhe pakonsekuençë nuk është e mundur të ndërtojsh me gjith fuqi mbretërinë e Zottit. Ne nuk do të marrim rifillim, nesë nuk ecim para me qartësi, konsekuençë dhe mee guxim të mëdha. Ata që veprojnë kështu do të përjetijnë rifillim, rilindje dhe zmadhim. Ne duhet të lejmë frkën pas nesh, që kur shkojnë ca njerëz, kjo është një dështim. Ne do të arrijmë më shumë nesë mësojmë të punojmë me ata që kanë vullnet dhe që i lëshojnë njerëzët, që nuk kanë vullnet, siç ka bërë Jezusi. Lavdi Zottit !

## Fund

---

Rifillimi kushton jetën tëndë, jetën personale, emrin tënd të mirë. Njerrëzët që të kanë respektuar, do të sillen në tjetër menyrë me ty. Nuk do të thotë që ti vepron gabimisht, por kur fillon më jetuar dhe më punuar me Shpirtin e Shenjtë, do të kundërshtim. Duhët të pagujsh çmimin. Jezusi e ka paguar për ty dhe për mua çmimin e shtrenjt. Ai nuk kishte pozitë ndër udhëheqëve kishtare atëhershëm, përkundrazi ishte në kundërshtim me ata. Por Jezusi kishte pozitë të Zoti. ai ishte në Zotin dhe Zoti ishte në Atë dhe Ai gjith vepronte pas vullnetit të Atit, për kë arsyе Jezusi ishte i sukseshëm.

**Studime biblike të shkurtëra vijuese gjendët në shtepi  
botuese Josua :**

- Nr.2- Pagëzimi me Shpirtin e Shenjtë
- Nr.5- Pagëzimi me ujë

**Adresa e porosisë:**  
Josua Verlag im  
Christlichen Missionswerk Josua  
Kirchsteig 6  
12524 Berlin  
GERMANY

• • • • • • • • •

ECKHARD NEUMANN, 54 vjeqar, i martuar, 4 fëmijë, të martuar dhe 10 nipër e mbesa, është drejtuesi dhe themeluesi i misionit "Josua" në Berlin dhe që për ringgjalljen e jetës në fryshtë e shenjtë, ka punuar kryesisht në zonën e ish-Gjermanise Demokratike.

Zoti e ka përdorur shërbimin e tij për të ngritur një numur zonash të reja dhe për të futur DDR-në, e dikurshme gjëra të reja. Ai punon në seksionin e udhëtimit dhe të mësimit të bashkësisë dhe në shkolla.



---

Natyra Jezusit dhe konsekuenca është shembull për jetën tonë. Një jetë pa kompromis, pa mirësi njëre zore, në një pjekuri konsekuente, i gatëshem për të paguar për një jetë më Shpirtin Shenjte - kjo është kjo - çka Zoti të Krishterët e fort më sjell deshiron. Kështu vjen njeriu në një jetë më plot fuqi.

Josua-Verlag



• • • • • • • • •

(